



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 188

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 6 nëntor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 234, datë 29.10.2024	Shfuqizimin e shkronjës “e”, të nenit 40, të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë” 20875
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 206, datë 7.10.2024	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shtator 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV..... 20875
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 207, datë 7.10.2024	Mbi kërkesën e shoqërisë “Teodori” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zalli i Bulqizës” dhe HEC “Ternovë” 20876
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 208, datë 7.10.2024	Mbi fillimin e procedurës lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 20878
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 209, datë 7.10.2024	Mbi fillimin e procedurës lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Delta Plan Studio” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike..... 20879
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 210, datë 7.10.2024	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Orher” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike..... 20880
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 211, datë 7.10.2024	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 20882
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 212, datë 7.10.2024	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.1.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Breçani R.O.S.P’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Drita’, me kapacitet të instaluar 1980 kW, të ndryshuar” 20883

**VENDIM****Nr. 234, datë 29.10.2024****SHFUQIZIMIN E SHKRONJËS “E”, TË
NENIT 40, TË RREGULLORES “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E BRENDSHËM TË KËSHILLIT TË
LARTË TË PROKURORISË”**

Bazuar në nenet 149, pika 1, 149/a, pika l, germa “e”, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 9; të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenet 164, 189, pika 1, germa “b”; dhe 190, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, miratuar me vendimin nr. 407, datë 17.12.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të shfuqizohet shkronja “e”, e nenit 40, të saj.

2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

3. U shpall në Tiranë, sot, më 29.10.2024.

KRYETAR
Mirela Bogdani

VENDIM**Nr. 206, datë 7.10.2024****MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË
FUNDIT PËR MUAJIN SHTATOR 2024
PËR KLIENTËT E LIDHUR NË
NIVELIN E TENSIONIT 35 kV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i

mundësisë së fundit, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)” nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin e ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.10.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2024/1 prot., datë 4.10.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin shtator 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 6225 prot., datë 1.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 2024 prot., datë 2.10.2024, ka përcjellë në ERE kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të muajit shtator 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit. Bazuar në aplikimin e sipërcituar, për muajin shtator 2024, shoqëria FSHU sh.a. e ka siguruar sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).

- Për përllogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për këtë periudhë (ÇBEt), shoqëria është bazuar në të dhënat e çmimeve orare të Tregut të Ditës në Avancë të ALPEX për muajin shtator 2024, profilet ditore të energjisë elektrike të prokuruar në bursë nga FSHU sh.a., si dhe vlerat rezultuese të faturave ditore. Në aplikimin e përcjellë nga ana e shoqërisë gjenden të bashkëlidhura tabelat me të dhënat e sipërcituara.

- Referuar aplikimit të shoqërisë FSHU sh.a., rezulton se është marrë në konsideratë kursi ditor i këmbimit (euro/lek), vlera të cilat janë bazuar në kurset zyrtare të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë për datat 29.08.2024 – 27.09.2024.

- Mbështetur në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shtator 2024 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të



transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, e cila për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, e cila mbështetur në vendimin të Bordit të ERE-s nr. 365, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”, vijon të jetë 1.55 lekë/kwh.

- Kostot administrative, të cilat në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 366, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, vijnë të jenë 1.06 lekë/kwh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shtator 2024, përlogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin shtator 2024</i>		
	Njësia	Çmimi
CBEt Çmimi mesatar i pondëruar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	13.01
Pr Kthimi për rrishtin e përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.39
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA		Lekë/kWh 16.86

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 16.86 lekë/kwh për muajin shtator 2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shtator 2024 prej 16.86 lekësh/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të Faqe | 20876

bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 207, datë 7.10.2024

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“TEODORI” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“ZALLI I BULQIZËS” DHE HEC
“TERNOVË”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe



të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1963/1prot., datë 3.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “Teodori” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zalli i Bulqizës” dhe HEC “Ternovë”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Teodori” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1963 prot., datë 23.9.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zalli i Bulqizës” dhe HEC “Ternovë”, referuar marrëveshjes së koncesionit të miratuar me VKM-në nr. 556, datë 1.8.2003, të ndryshuar.

- Bordi i komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 83, datë 4.11.2009, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Teodori 2003” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zall Bulqizës” me fuqi 5.350 mw dhe HEC “Ternovë” me fuqi 8.385 mw, me afat vlefshmërie 30 vjet.

- Rezulton se me VKM-në nr. 556, datë 1.8.2003, është miratuar marrëveshja e koncesionit e formës “BOO” ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Teodori” sh.p.k. për ndërtimin e hidrocentraleve në Ternovë dhe në Zall të Bulqizës, e cila është ndryshuar në vijim me VKM-në nr. 123, datë 14.3.2007 dhe VKM-në nr. 477, datë 3.6.2015.

- Marrëveshja e koncesionit, e miratuar me vendimin nr. 477/2015, është nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe shoqërisë “Teodori” sh.p.k. (në cilësinë e koncesionarit), ku ndër të tjera, në nenin 5 të saj, është parashikuar se: brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje, koncesionari do të formojë shoqërinë koncesionare.

- Rezulton se për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet e përcaktuara në marrëveshjen e koncesionit të miratuar me VKM-në nr. 556/2003, është licencuar tashmë një shoqëri dhe ajo është “Teodori 2003” e po ashtu, aplikuesi, shoqëria “Teodori” sh.p.k., nuk ka depozituar ndonjë miratim me shkrim të MIE-s për të kaluar të drejtën e operimit të hidrocentraleve “Ternovë” dhe “Zall i Bulqizës” te koncesionari,

shoqëria “Teodori” sh.p.k., fakt ky i bërë me dije edhe më herët shoqërisë, në kuadër të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 75/2024, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Teodori” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zalli i Bulqizës” dhe HEC “Ternovë”.

- Për qëllime të pajisjes me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, rezulton se nga ana e shoqërisë “Teodori” sh.p.k. është depozituar dhe sa vijon:

- Shkresa e MIE-s nr. 1346 prot., datë 7.2.2024, e administruar edhe më herët nga ERE, e cila i drejtohet shoqërisë “Teodori” sh.p.k., duke vënë për dijeni ERE-n dhe shoqërinë koncesionare “Teodori 2003” në të cilën MIE shprehet se: bazuar në përcaktimet e nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, kërkesa për transferimin e licencës është objekt shqyrtimi i Entit Rregullator të Energjisë, dhe se ajo nuk jep pëlqimin mbi transferimin e licencës nr. 83, datë 4.11.2009, nga shoqëria koncesionare “Teodori 2003” sh.p.k. tek shoqëria “Ternovë Zall Bulqizë” sh.p.k., ka shërbyer në kuadër të vendimarrjes së Bordit të ERE-s nr. 54/2024, “Mbi heqjen e pezullimit të vendosur me vendimin e Bordit nr. 240, datë 3.8.2023, ‘Mbi pezullimin e vendimarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k. për transferimin e pjesës së licencës për prodhimin e energjisë elektrike, për HEC “Zalli i Bulqizës”, te shoqëria “Koncesionare Ternovë Zall Bulqizë” sh.p.k.”. Sikurse rezulton nga kjo shkresë, përveç faktit që aplikimi i shoqërisë “Teodori” sh.p.k., në ERE është bërë për pajisjen me licencë nga e para dhe jo transferimin e një licence aktuale, MIE (e cila në marrëveshjen e koncesionit të miratuar me VKM-në nr. 556/2003, është në rolin e autoritetit shtetëror të autorizuar), nuk ka dhënë pëlqimin për transferimin e licencës së shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k. Gjithashtu, nuk rezulton që në këtë shkresë të jetë dhënë ndonjë miratim i MIE-s për të kaluar të drejtën e operimit të hidrocentraleve “Ternovë” dhe “Zall i Bulqizës”, që rrjedh nga marrëveshja e koncesionit, te koncesionari, shoqëria “Teodori” sh.p.k.

- Shkresa e “Operatorit të Sistemit të Transmetimit” sh.a., nr. 2759/1 prot., datë 22.5.2024, drejtuar shoqërisë “Teodori” sh.p.k., ku në përgjigje të kërkesës së kësaj të fundit për ndryshim të emrit të shoqërisë në lidhjen e centralit me rrjetin, “OST” sh.a. shprehet se: midis “OST”



sh.a. dhe shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k. është lidhur marrëveshja me rrjetin e datës 6.3.2015, e po ashtu se shoqëria “Teodori” sh.p.k. nuk ka depozituar pranë “OST” sh.a. ndonjë miratim me shkresë të MIE-s për të kaluar të drejtën e operimit të HEC te koncesionari, shoqëria “Teodori” sh.p.k.

Për sa më sipër, nuk rezulton që koncesionari, shoqëria “Teodori” sh.p.k., të ketë marrë ndonjë miratim nga operatori i rrjetit, që pika e lidhjes së HEC “Ternovë” dhe “Zall Bulqizë”, t’i kalojë atij.

- Shkresa e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) nr. 5474/1 prot., datë 27.3.2024, drejtuar shoqërisë “Teodori” sh.p.k., ku në përgjigje të kërkesës së kësaj të fundit për ndryshimin e emrit në lejen mjedisore, nga ana e AKM-së informohet shoqëria, ndër të tjera, se, bazuar në dokumentacionin dhe deklaratimet e depozituara, kjo nuk është një procedurë për ndryshim emri, por transferim nga subjekti “Teodori 2003” sh.p.k. dhe se kërkesa e saj nuk mund të procesohet.

Për sa më sipër, edhe organi përgjegjës për menaxhimin e mjedisit ka konfirmuar që leja e mjedisit është lëshuar në emër të shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k., e cila është dhe shoqëria e licencuar nga ERE, dhe nuk mund të vijohet me transferimin e kësaj lejeje.

- Shkresa e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) nr. 972/1 prot., datë 22.7.2024, drejtuar MIE-s, për dijeni subjekti “Teodori” sh.p.k., dhe ZABU Drin-Bunë, me anë të së cilës bëhet me dije se me shkresën e datës 28.6.2024, shoqëria “Teodori” sh.p.k. i është drejtuar me kërkesën për korrigjimin e gabimeve materiale dhe ndryshimin e emrit nga subjekti “Teodori 2003” sh.p.k. tek subjekti “Teodori” sh.p.k. Në këtë shkresë AMBU-ja ka kërkuar nga MIE qartësimin përkatës, në lidhje me kërkesën e subjektit për sa i përket emërtimeve në kontratën e koncesionit dhe shtesat vijuese të saj.

Nuk rezulton që në vijim të jetë depozituar ndonjë kthim përgjigjeje e MIE-s, por as AMBU-ja nuk ka marrë ndonjë vendim që lejet e ujit përkatëse për prodhimin e hidroenergjisë, të cilat janë lëshuar për shoqërinë koncesionare “Teodori 2003” sh.p.k. t’i kalojnë shoqërisë “Teodori” sh.p.k.

- Përveç sa më sipër, kjo çështje është shqyrtuar tashmë nga ERE dhe janë marrë vendimet përkatëse (nr. 68, datë 11.4.2022; nr. 75, datë 29.4.2024; nr. 54, datë 2.4.2024), ku në asnjërin prej tyre nuk rezulton që të jetë miratuar kërkesa e shoqërisë “Teodori” sh.p.k.

- Po ashtu, nga ana e aplikuesit nuk është kryer pagesa e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe sikurse konstatuar mungon dokumentacioni thelbësor i kësaj procedure për të vijuar me trajtimin dhe shqyrtimin e një aplikimi për licencim në veprimtarinë e prodhimit, ndaj vlerësohet mosfillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Teodori” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zalli i Bulqizës” dhe HEC “Ternovë”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Teodori” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 208, datë 7.10.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 1” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika



1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2021/1 prot., datë 3.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Erseka Solar Park 1’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2021 prot., datë 1.10.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të rregullores dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat: “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.5.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendrike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të

Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 209, datë 7.10.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DELTA PLAN STUDIO” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1968/1 prot., datë 3.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Delta Plan Studio’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Delta Plan Studio” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1968 prot., datë 25.9.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelce, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier.



- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të rregullores dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, gerrat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Delta Plan Studio” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 2058 rep., nr. 642 kol., datë 23.5.2024, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, në zonën kadastrale nr. 3038, në fshatin Povelce, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘Delta Plan Studio’ sh.p.k.”;

- Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., marrëveshjen e lidhjes së re 7330/2 prot., datë 6.9.2023 dhe ka marrë miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së “OSSH” sh.a. nr. 7330/3 prot., datë 6.9.2023;

- Është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar më datë 18.12.2023 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i centralit fotovoltaike ‘Delta Solar Park’, 2 mw”. VNM-ja paraprake e depozituar nga shoqëria është aktualisht e vlefshme (deri më 18.12.2025), por vlerësohet t’i kërkohej asaj të bëjë me dije në rast se ka filluar punimet për ndërtimin e centralit dhe nëse po, t’i dokumentojë ato në ERE.

- Po ashtu, referuar përcaktimeve të nenit 9, të kontratës me nr. 2058 rep., nr. 642 kol., datë 23.5.2024, nënshkruar me MIE-n, shoqëria duhet të ridepozitojë aneksin A të kësaj kontrate, pasi dokumenti i depozituar nuk është i qartë dhe nuk mund të identifikohen të dhënat e tij, që mund të shërbejnë për përlogaritjen e afateve përkatëse. Përveç kësaj, shoqëria duhet të depozitojë informacion nëse është pajisur me lejen e ndërtimit apo nëse ka filluar punimet për ndërtimin e centralit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Delta Plan Studio” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Delta Plan Studio” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 210, datë 7.10.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “ORHER” SHPK, PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-



s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1958/1 prot., datë 3.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Orher’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Orher” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1958 prot., datë 23.9.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a” “b” dhe “c”; në pikën 1.2, germat: “a”, “c” dhe “d”; në pikën 1.3, germa “a”; në pikën 2.1, germat: “b”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Orher” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 2996 rep., nr. 1957 kol., datë 24.5.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, në zonën e Semanit, në fshatin Povelce, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘Orher’ sh.p.k.”;

- Ka marrë miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së “OSSH” sh.a. nr. 2740/3 prot., datë 20.3.2023; Është pajisur me vendim për VNM paraprahe, lëshuar më datë 11.4.2023, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Impianti Fotovoltaike Orher, 2 mw”. VNM-ja paraprahe e depozituar nga shoqëria është aktualisht e vlefshme (deri më 11.4.2025), por vlerësohet t’i kërkohej asaj të bëjë me dije në rast se ka filluar punimet për ndërtimin e centralit dhe nëse po, t’i dokumentojë ato në ERE.

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet me data të përditësuara.

- germa “c”: Shoqëria duhet të informojë se cila është struktura aktuale organizative e saj, pasi ka depozituar një strukturë bashkëlidhur planit të biznesit dhe një strukturë tjetër më vete.

Pika 1.3.

germa “b”: Shoqëria duhet depozitojë në ERE informacion/dokumentacion në rast se ka pasur ndryshime në vlerën e investimit, një dokument të përditësuar nga banka, në lidhje me financimin e projektit, si dhe të sqarojë raportin në përqindje të financimit të projektit, nëse do të realizohet 100% nga banka, apo dhe nga fonde të vetat.

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1

- germa “a”: Shoqëria duhet të plotësojë kapacitetin e instaluar të secilës prej njësive, dokumentacion teknik mbi jetëgjatësinë e centralit dhe një datë të saktë për fillimin e operimit.

- germa “c”: Shkresa e “OSSH” sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes është depozituar në format fotokopje, ndaj do t’i kërkohej shoqërisë që ta depozitojë atë në format origjinal ose fotokopje të njësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Orher” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Orher” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data



e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 211, datë 7.10.2024

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “DEVOLL
HYDROPOWER” SHA, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gema “e”, 5, pika 1, germa “e”, 13, si dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1598/5 prot., datë 3.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Devoll Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1588/1 prot., datë 4.9.2024, paraqiti kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 194, datë 18.9.2024, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 274, seria T15/T20, të

shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.3.2015 dhe rinovuar në vijim me vendimin nr. 159, datë 29.10.2019.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 19.9.2024 dhe 20.9.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 30.9.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1598/4 prot., datë 20.9.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin për fillimin e procedurës.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të rregullores së licencimit.

- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa u përket pagesave të rregullimit.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 6.3.2025.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 212, datë 7.10.2024

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 9, DATË
21.1.2022, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘BREÇANI R.O.S.P’ SHPK,
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
‘DRITA’, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1980 kw, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 52/7 prot., datë 20.9.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.1.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Breçani R.O.S.P’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Drita’, me kapacitet të instaluar 1980 kw, i ndryshuar”

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s vendosi të licencojë shoqërinë “Breçani R.O.S.P” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin nr. 9, datë 21.1.2022, të ndryshuar, në vijim me vendimin nr. 232, datë 12.9.2022 dhe me vendimin nr. 82, datë 2.5.2024, me kushtet si më poshtë: 1. Të licencojë shoqërinë “Breçani R.O.S.P” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Drita”, me kapacitet të instaluar 1980 kw, për një afat 30-vjeçar. 2. Shoqëria “Breçani R.O.S.P” sh.p.k. të depozitojë në ERE certifikatën e pronësisë për zonën ku ushtron veprimtarinë HEC “Drita”, brenda datës 12.7.2024. 3. Shoqëria “Breçani R.O.S.P” sh.p.k., të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të burimit uhor sipërfaqësor, deri në datën 12.7.2024. 4. Në rast se shoqëria “Breçani R.O.S.P” sh.p.k., ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtarë i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrorë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, deri

në depozitimin e lejes së rinovuar për përdorimin e burimit uhor sipërfaqësor. 5. Ky vendim është objekt rishikimi nga Bordi i ERE-s, sipas përcaktimeve të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi.

- ERE, me shkresën nr. 52/2 prot., datë 13.5.2024, ka njoftuar shoqërinë “Breçani R.O.S.P” sh.p.k. mbi vendimin e Bordit të ERE-s nr. 82, datë 2.5.2024, duke i sjell në vëmendje afatet e lëna për plotësimin e kushteve të lëna në pikat 2 dhe 3.

- Në kuadër të plotësimit të kushtit të lënë në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 9/2022, të ndryshuar, ku i është lënë shoqërisë kushti që të depozitojë në ERE certifikatën e pronësisë për zonën ku ushtron veprimtarinë HEC “Drita”, brenda datës 12.7.2024.

- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 52/3 prot., datë 5.7.2024 ka depozituar informacion mbi ecurinë e aplikimit për pajisjen me certifikata pronësie nga ASHK Tropojë.

- Në vijim, ERE me shkresën nr. 52/5 prot., datë 6.9.2024, i kërkoi shoqërisë “Breçani R.O.S.P” sh.p.k. informacion mbi statuset e aplikimit në ASHK Tropojë dhe depozitimin e dokumentacionit pronësor, në kuadër të kërkesave të kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s.

- Shoqëria, në përgjigje të shkresës së ERE-s dhe në kuadër të plotësimit të këtij kushti me shkresën e protokolluar në ERE nr. 52/6 prot., datë 9.9.2024, depozitoi dokumentacionin e pronësisë për tokën shtet në zonën ku ushtron veprimtarinë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Drita”.

- Për sa më sipër depozituar është plotësuar kushti i lënë mbi depozitimin e certifikatave të pronësisë dhe kartelave shoqëruese me shënimet përkatëse për zonën ku ushtron veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Drita”, sipas kontratës së nënshkruar me MIE-n për një afat 49-vjeçar. Ajo që evidentohet në dokumentacionin e depozituar është afati i kartelave, të cilat referojnë një afat 999-vjeçar, i cili ndoshta është një gabim material. Gjithsesi, në çdo rast, për sa i përket dokumentacionit që vlen për rishikimin e këtij vendimi, vlerësohet se ky dokumentacion përmbush kushtin e lënë mbi pronësinë në zonën ku ushtron veprimtarinë HEC “Drita”. Si e tillë, pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s vlerësohet të shfuqizohet.



- Në kuadër të plotësimit të kushtit të lënë në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 9/2022, të ndryshuar, ku i është lënë shoqërisë kushti që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të burimit ujqor sipërfaqësor deri në datën 12.7.2024. Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 52/3 prot., datë 5.7.2024 ka depozituar informacion se aplikimi për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor tashmë mban statusin “Kalim për mbledhjen e Këshillit të Basenit Ujqor”, dhe se kjo mbledhje do të zhvillohet brenda muajit korrik 2024.

- Në vijim të informacionit të depozituar nga shoqëria, ERE me shkresën nr. 633/30 prot., datë 24.7.2024, iu drejtua AMBU-së me kërkesën për informacion, në lidhje me statutet e aplikimeve të bëra nga subjektet që kemi në proces trajtimi, ndër të tjera u pyet edhe nëse është miratuar leja e përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor nga Këshilli i Basenit Ujqor për shoqërinë “Breçani R.O.S.P” sh.p.k.

- Në përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 633/40 prot., datë 6.8.2024, AMBU-ja ka konfirmuar se aplikimi për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor nga shoqëria “Breçani R.O.S.P” sh.p.k. është miratuar nga organet e menaxhimit të burimeve ujqore me anë të vendimit nr. 11, datë 30.7.2024. Procesi është në fazën e kryerjes së pagesës së tarifës për marrjen e lejes nga subjekti përfitues.

- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 52/4 prot., datë 14.8.2024, ka depozituar vendimin e Këshillit të Basenit Ujqor Drin-Bunë me nr. 11, datë 30.7.2024, për miratimin e rinovimit të lejes nr. 575 prot., datë 12.12.2018, për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik, shoqërisë “Breçani R.O.S.P” sh.p.k. Lejen për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor nr. 303 prot., datë 31.7.2024, me nr. serie 000207, për prodhim hidroenergje nga HEC “Drita”. Në këtë leje përcaktohet se periudha e vlefshmërisë së saj është për 5 (pesë) vite, deri më datën 30.7.2029.

- Me depozitim të këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s, por duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe po ashtu i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që kjo pikë të ndryshojë, duke i lënë kushtin shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim

hidroenergje nga HEC “Drita”, brenda datës 30.7.2029.

- Me ndryshimin e pikës 3 vlerësojmë të ndryshojmë dhe pikën 4 me përmbajtjen: Në rast se shoqëria nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrtojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Për sa sqarohet më sipër vlerësojmë të ndryshojmë dhe pikën 5 të vendimit nr. 9, datë 21.1.2022, të ndryshuar, si në vijim: “5. Ky vendim është objekt rishikimi nga Bordi i ERE-s, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi.”

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimin e tij, me nismën e vetë organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.12.2022, i ndryshuar, të shfuqizohet.

2. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.12.2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“3. Shoqëria “Breçani” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor brenda datës 30.7.2029.”

3. Pika 4 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.12.2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“4. Në rast se shoqëria nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrtojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.”

4. Pika 5 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.1.2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“5. Ky vendim është objekt rishikimi nga Bordi i ERE-s në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të



Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë

